

L I G J
Nr.8260, datë 26.11.1997

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7980, DATË 27.7.1995 "PËR SHITBLERJEN E TROJEVE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh të Partisë Socialdemokrate,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 5 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", pas paragrafit të katërt shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Shtetet apo organizatat ndërkombëtare, në të njëjtat kushte, si edhe personat fizikë dhe juridikë shqiptarë, kanë të drejtë të blejnë truall pronë private apo shtetërore për të ndërtuar selitë e misioneve të tyre, për të blerë truallin mbi të cilin i kanë ndërtuar ose vazhdojnë t'i ndërtojnë ato.

Përfitimi nga kjo e drejtë bëhet mbi bazë reciprociteti, duke përfituar ai shtet që i njeh të njëjtën të drejtë shtetit shqiptar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.1963, datë 2.12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani